REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES

Nr. _____ prot., Tiranë ____.____.2026

V E N D I M

Nr. 31 datë 06.11.2026

PËR MIRATIMIN PËR KËSHILLIM PUBLIK TË DOKUMENTIT "MBI DHËNIEN E TË DREJTAVE TË PËRDORIMIT NË BREZIN E FREKUENCAVE 2100 MHZ (1920-1935 MHZ TË ÇIFTUAR ME 2110-2125 MHZ)"

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

Z.	**Gentian Sala**	**Kryetar**
Znj.	**Edlira Dvorani**	**Anëtar**
Z.	**Armer Juka**	**Anëtar**
Z.	**Bleron Dokle**	**Anëtar**
Znj.	**Diana Dervishi**	**Anëtar**

dhe sekretare znj. Dania Nallbani, në mbledhjen e datës 06 nëntor 2026, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 54/2024 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike" dhe Rregullores së Brendshme për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP)" miratuar me vendimin nr.11, datë 31.03.2026, të Këshillit Drejtues të AKEP me propozim të Grupit të Punës shqyrtoi çështjen me objekt:

- "Miratimin për konsultim publik të dokumentit "Mbi dhënien e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 2100 MHz (1920–1935 MHz të çiftuar me 2110–2125 MHz)"

BAZA LIGJORE:

1. Neni 14, neni 44 dhe neni 75 i ligjit nr. 54/2024 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë";
2. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 756, datë 13.12.2024 "Për miratimin e Planit Kombëtar të Frekuencave";

3. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 70, datë 06.02.2026 “Për miratimin e rregullave për procedurën e konkurrimit publik për dhënien e autorizimeve individuale për të drejta të përdorimit të frekuencave”;
4. Vendimi i Këshillit Drejtues të AKEP nr. 07, datë 06.09.2023 “Për miratimin e Planit të Caktimit dhe Përdorimit të Radiofrekuencave në Republikën e Shqipërisë,

KËSHILLI DREJTUES

Pasi shqyrtoi materialin shkresor, të përbërë nga:

1. Shkresa me nr. prot. LEA/1053/LR, datë 29.06.2026, e sipërmarrësit “Vodafone Albania” sh.a., me objekt “Shprehjen e interesit paraprak për pjesëmarrjen në ankandin e brezit 2100 MHz dhe rinovimin e spektrit 2x5 MHz që përfundon në tetor 2026”, protokolluar në AKEP me shkresën nr. 1566 prot., datë 30.06.2026;
2. Urdhrin nr. 209, datë 20.10.2026, të Titullarit të AKEP, për ngritjen e Grupit të Punës për përgatitjen e dokumentit për këshillim publik;
3. Dokumenti për Këshillim Publik “Mbi dhënien e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 2100 MHz (1920–1935 MHz të çiftuar me 2110–2125 MHz)”;
4. Relacioni shpjegues i Grupit të Punës mbi miratimin për këshillim publik të dokumentit “Mbi dhënien e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 2100 MHz (1920–1935 MHz të çiftuar me 2110–2125 MHz)”;
5. Projektvendimi i formatuar dhe arsyetuar.

si dhe duke iu referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, dhe bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

1. AKEP, në përputhje me ligjin nr. 54/2024, është autoriteti përgjegjës për administrimin dhe menaxhimin e spektrit të radiofrekuencave dhe për dhënien e të drejtave individuale të përdorimit të frekuencave, në përputhje me Planin Kombëtar të Frekuencave dhe aktet përkatëse rregullatore në fuqi, duke synuar përdorimin efektiv dhe eficient të tij, nxitjen e konkurrencës dhe promovimin e investimeve në rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike.
2. Sasia e spektrit prej 2x15 MHz (FDD) në brezin 2100 MHz është aktualisht e lirë dhe e disponueshme për administrim nga AKEP, pasi Këshilli Drejtues i AKEP mori vendimin nr. 6, datë 13.03.2026, për mosrinovimin e autorizimit individual të “Vodafone Albania” sh.a., për 15 MHz të çiftuar dhe 5 MHz të paçiftuar. Në këtë vendim është përcaktuar lirimi i brezit brenda gjashtë muajve nga marrja e njoftimit të vendimit (shtator 2026).

Gjithashtu, në brezin 800 MHz evidentohet si i lirë spektri 2x10 MHz në frekuencat 791–801 MHz të çiftuara me 832–842 MHz.

3. Sipërmarrësi "Vodafone Albania" sh.a., me shkresën LEA/1053/LR, datë 29.06.2026, protokolluar në AKEP me nr. 1566 prot., datë 30.06.2026, ka paraqitur shprehjen e interesit për pjesëmarrje në procedurat e ardhshme të dhënies së të drejtave të përdorimit të spektrit radiofrekuencor në brezin 2100 dhe 800 MHz .
4. Në pikat 1 dhe 2 të nenit 75 të ligjit nr. 54/2024 përcaktohet se, kur AKEP, në bazë të vlerësimit të tregut, konsideron se interesi për një brez të caktuar frekuencash mund të tejkalojë disponueshmërinë e frekuencave në këtë brez dhe, për të siguruar përdorimin efikas të tyre, kryen një proces konsultimi publik me palët e interesuara për kushtet e përdorimit të këtij brezi frekuencash dhe procedurën që do të zbatohet për alokimin e tyre. Gjithashtu, AKEP, kryen procesin e konsultimit publik me paraqitjen e një kërkese nga çdo palë e interesuar për frekuenca specifike, jo më vonë se 30 ditë pas paraqitjes së kërkesës.
5. Titullari i AKEP, me Urdhrin nr. 209 datë 20.10.2026 (nr. 1566/1 prot, datë 20.10.2026), ka ngritur Grupin e Punës për përgatitjen e dokumentit për këshillim publik "Mbi dhënien e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 2100 MHz (1920–1935 MHz të çiftuar me 2110–2125 MHz)".
6. Grupi i Punës, brenda afatit të përcaktuar në urdhër, ka përgatitur dokumentin për këshillim publik "Mbi dhënien e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 2100 MHz (1920–1935 MHz të çiftuar me 2110–2125 MHz)". Në përgatitjen e dokumentit, Grupi i Punës është bazuar në kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, Planin Kombëtar të Frekuencave, Planin e Caktimit dhe Përdorimit të Radiofrekuencave, si dhe aktet dhe rekomandimet përkatëse evropiane dhe ndërkombëtare. Në përgatitjen e Dokumentit për Konsultim Publik janë marrë në konsideratë, ndër të tjera, Vendimi i Komisionit 2012/688/BE dhe Vendimi i Komisionit (BE) 2020/667, lidhur me përdorimin e brezit 1920-1980/2110-2170 MHz për sistemet MFCN dhe përditësimin e kushteve teknike të përdorimit të këtij brezi.
7. Dokumenti për konsultim publik propozon dhënien e 1 (një) të drejte individuale përdorimi për një sasi spektri prej 2x15 MHz (FDD), konkretisht në brezat 1920–1935 MHz, të çiftuar me 2110–2125 MHz dhe përcakton çështjet kryesore për të cilat kërkohet mendimi i operatorëve dhe palëve të tjera të interesuara, sipas përcaktimeve në pikën 3 të nenit 75 të ligjit nr. 54/2024. Konkretisht, AKEP kërkon mendimet e operatorëve dhe të palëve të interesuara, ndër të tjera, lidhur me:

   - vlerën ekonomike të së drejtës së përdorimit të 2x15 MHz;
   - faktorët që duhet të merren në konsideratë në përcaktimin e vlerës së spektrit;
   - mundësinë e zhvillimit të një procedure konkurruese multiband, duke përfshirë edhe brezin 800 MHz;
   - kushtet dhe objektivat e mbulimit me shërbime;
   - kohëzgjatjen e vlefshmërisë së autorizimit individual;
   - mënyrën e pagesës së vlerës së së drejtës së përdorimit;
   - teknologjinë dhe mënyrën e shfrytëzimit të spektrit;

- çdo çështje tjetër të lidhur me përdorimin efektiv dhe eficient të këtij burimi të kufizuar.

8. Zhvillimi i këshillimit publik është i nevojshëm për vlerësimin e kërkesës së tregut, vlerës ekonomike të spektrit, ndikimit në konkurrencë, kushteve të përdorimit dhe alternativave të mundshme procedurale, me qëllim sigurimin e një vendimmarrjeje objektive, transparente dhe të mirëinformuar.
9. Dokumenti për Konsultim Publik "Mbi dhënien e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 2100 MHz (1920–1935 MHz të çiftuar me 2110–2125 MHz)" përmbush kërkesat ligjore dhe rregullatore për zhvillimin e procesit të konsultimit publik dhe krijon kushtet për marrjen e mendimeve dhe komenteve të operatorëve dhe palëve të tjera të interesuara mbi kushtet, kriteret dhe procedurën për dhënien e të drejtave të përdorimit të frekuencave në këtë brez.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në pikën 1 të nenit 14, dhe pikën 1 të nenit 15 të ligjit nr. 54/2024 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë" dhe ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", si dhe Këshilli Drejtues i AKEP,

VENDOSI:

1. Të miratojë për konsultim publik dokumentin "Mbi dhënien e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 2100 MHz (1920–1935 MHz të çiftuar me 2110–2125 MHz)", sipas dokumentit bashkëlidhur, i cili është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Procedura e Konsultimit Publik të zhvillohet për një periudhë prej 30 (tridhjetë) ditësh kalendarike, duke filluar nga data e publikimit të dokumentit në faqen zyrtare të internetit të AKEP, sipas pikës 3, të këtij vendimi.
3. Ky vendim dhe dokumenti për konsultim publik "Mbi dhënien e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 2100 MHz (1920–1935 MHz të çiftuar me 2110–2125 MHz)" të publikohen në faqen zyrtare të internetit të AKEP www.akep.al.
4. Ngarkohet administrata e AKEP, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar	Anëtar
Gentian Sala	**Edlira Dvorani**	**Armer Juka**	**Bleron Dokle**	**Diana Dervishi**